

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "Veramentia
Albania"SH.P.K.**

**KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME
NENI 1**

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, sot me dt. 04.09.2018 dhe vendimit të asamblesë së shoqërisë themeluese Veramentia Estate LTD datë 31.07.2018, me vullnet të lirë Ortaku i vetëm themelues:

1. **Veramentia Estate LTD** shoqëri me përgjegjësi të kufizuara e themeluar dhe regjistruar rregullisht sipas legjisacionit tregtar te Qipros në datë 20 dhjetor 1999, vërtetuar me certifikatën nr. NE 107469 C.C.4 datë 08 qershori 2018, përfaqësuar nga Drejtora zj. Koulla Anastasiou, përfaqësuar për hartimin dhe nënshkrimin e këtij akti themelimi nga zj. Isida Guçe mbajtëse e pasaportës nr. B13175010.

si themeluese të kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartojë këtë akt themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

KREU II

EMRI, FORMA, SELIA, KOHEZGJATJA

**NENI 2
EMRI**

Emri i shoqërisë është "**Veramentia Albania"SH.P.K.**

**NENI 3
FORMA**

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortaku do të përballojë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara për kapitalin.

**NENI 4
SELIA**

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, në adresën: Autostrada Tiranë – Durrës, Km. 10, Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 5
AFATI**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

KREU III

**O B J E K T I
NENI 6**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Veprimtari në fushën e ndërtimit të të gjitha llojeve, duke përfshirë ndërtesat për qëllime banimi, ndërtimi të karakterit social, kulturor, industrial, kanalizimi, rehabilitimin dhe ndërtimin e autostradave, etj, por pa u kufizuar ne to dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë;
- Import-eksport dhe tregti me shumicë-pakicë, të produkteve industriale, ushqimore, bujqësore, minerale etj.
- Import - eksport i materialeve të ndërtimit dhe të gjitha llojet e materialeve inerte, të lëndëve të para dhe të produkteve të përgatitura gjysmë të përgatitura, si dhe tregtia e materialeve të ndërtimit.

**KAPITALI
NENI 7**

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën prej EUR 2,694,247 (dy milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e dyzetë e shtatë euro) dhe do të jetë në formën e kontributit në natyrë me pasuri të paluajtshme nga ana e ortakut të vetëm. Kuota e kapitalit themeltar të shoqërisë është e ndarë dhe nënshkruar si më poshtë:

1. Veramentia Estate LTD në cilësinë e ortakut themelues zotëron **100%** të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabartë me vlerën prej EUR 2,694,247 (dy milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e dyzetë e shtatë euro).

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

**KREU IV
ORGANET E SHOQËRISË**

NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

**ORGANI ADMINISTRATIV
NENI 9**

Administratore e parë e shoqërisë është zj. Majlinda Hido, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 027846792.

**KREU V
PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE**

NENI 10

OrtakU themelues mund të vendosë me vullnetin e tij për të marrë pjesë në shoqëri të tjera, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12
Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i shoqërisë dhe legjislacioni tregtar në fuqi.

NENI 13
Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në dy kopje origjinale me te njëjtën fuqi ligjore.

THEMELUES
Veramentia Estate LTD
Përfaqësuar nga Isida Guçe

